



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilmen/Prodato Received/Delivery	28.10.2022	viti god. year	
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6527/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.816/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.816/2022 të datës 23.09.2022, të parashtruar nga grupi i ankuesve:

të cilët me autorizim i përfaqëson

me adresë banimi

kundër organit të punësimit/Ministria e Financave,

Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 28.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.816/2022, e datës 23.09.2022 e parashtruar nga

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.225 te datës 16.04.2014 ne pozitën "Zyrtar i bazës së të dhënave për skemat pensionale". Ankuesja Sh. E është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.254 të datës 10.04.2014 në pozitën "Zyrtare e kontrollit dhe mbikëqyrjes se përfitimeve nga skemat pensionale' si dhe ankuesja Z. B është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.258 të datës 16.04.2014 në pozitën "Zyrtare për vendime dhe pagesa'.



Me datën 06.09.2022 të njëjtit përmes përfaqësueses ligjore, kanë parashtruar kërkesën Nr.Prot.1913-7/2022 për tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera. Ndërsa me datën 23.09.2022 përmes përfaqësueses ligjore kanë parashtruar ankesën me numër të protokollit 5629/2022, për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 30.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datën 10.10.2022 kjo e fundit ka përcjellë dokumentacionin lidhur me ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 5629/2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën Nr.Prot.1913-7/2022 e datës 06.09.2022 e parashtruar nga ankuesit tek organi i punësimit; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore për Sh. E; Kartelën e bankës për Sh. E; Akt emërimit e ankueses Sh. E Nr.Prot.254 te datës 10.04.2014; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesen Sh. E; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore për ankuesin F. Gj; Kopjen e kartelës se bankës dhe kopjen e letërnjoftimit për ankuesin F. Gj; Akt emërimit e ankuesit F. Gj Nr. Prot.225 te datës 16.04.2014; Kontratën e marrëdhënies e punës për ankuesen Z. B me numër 848 te datës 22.01.2007; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore e ankueses për Z. B; Kopjen e letërnjoftimit dhe kartelës se bankës për ankuesen Z. B; ; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen ne ankesë të datës 10.10.2022 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin e datës 04.10.2022 lidhur me transferimin e ankueses Z. B; Listën e pagave për muajin gusht te vitit 2017 për ankuesen Z. B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesve F. Gj, Sh. E dhe Z. B **është e palejuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesve, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: "1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj", andaj duke marrë parasysh konstatimin si më lartë se ankuesit përmes përfaqësueses ligjore me datën 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë fillimisht pranë organit të punësimit, ndërsa me datën 23.09.2022 fizikisht kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshill ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative nga ana e organit të punësimit, kështu që ankesa e ankuesve është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafit 1 dhe nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.816/2022, datë 28.10.2022

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuese me autorizim e ankuesve,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

